



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
P-075
Prishtinë, më 7 tetor 2016, ora 15:00h

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 7 TETOR 2016**

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Në fillim të seancës, kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, propozoi që në këtë seancë të shqyrtohet vetëm Projektligji për “Trepçën”, ndërsa 12 pikat tjera të shtyhen për një seancë tjetër.

Kryetari kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e kryetarit të GP të LK-së.

Kryetari i GP të Listës serbe, Slavko Simiq, propozoi që shqyrtimi i parë të Projektligjit për “Trepçën” të hiqet nga rendi i ditës i kësaj seance.

Kryetari kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e kryetarit të GP të LS.

Pas deklarinimit të kryetarëve të grupeve parlamentare, kryetari i hodhi në votim një nga një propozimet e lartshënuara.

Për propozimin e kryetarit të GP të LDK-së, rezultati i votimit ishte ,si në vijim:

Për ----- 73,
Kundër ----- 8,
Abstenime ----- 0.

Për propozimin e kryetarit të GP të LS, rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 8,
Kundër ----- 86,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash vendosi që në seancën e sotme të shqyrtohet vetëm Projektligji për “Trepçën”, ndërsa pikat e tjera të parapara për këtë seancë shtyhen për seancën tjetër të radhës.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-120 për “Trepçën”

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 3 tetor 2016, ka vendosur t’ia propozojë Kuvendit që shqyrtimi dhe miratimi i projektligjit të bëhet me procedurë të përshpejtuar - shmangie nga afatet procedurale.

Kryetari kërkoi deklarin e kryetarëve të grupeve parlamentare për propozimin e lartshënuar.

Pas deklaramit të kryetarëve të grupeve parlamentare, kryetari e hodhi në votim propozimin për shmangie nga afatet procedurale për shqyrtimin dhe miratimin e Ligjit për “Trepçën”.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----71,
Kundër -----16
Abstenime ----- 0

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash:

V E N D O S I

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për “Trepçën” të bëhet në seancën plenare më 7 tetor 2016 me procedurë të përshpejtuar - shmangie nga afatet procedurale të parapara më nenin 15.7, nenin 56. 1 dhe më nenin 57, paragrafët 3, 8 dhe 9 të Rregullores së Kuvendit.

2. Pas miratimit në shqyrtim të parë, Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe komisionet e përhershme duhet ta shqyrtojnë Projektligjin për “Trepçën” dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

3. Shqyrtimi i dytë Projektligjit për “Trepçën” të bëhet pas përfundimit të kësaj seance, në seancën e re plenare, më 7 tetor 2016, në orën 20:30h.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

* * *

Pastaj, kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa, e paraqiti dhe e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit Projektligjit nr. 05/L-120 për “Trepçën”. Diskutimi i kryeministrit është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Lidhur me Projektligjin nr. 05/L-120 për “Trepçën” diskutuan: Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Sala Berisha Shala, në emër të GP të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të GP të LVV-së; Pal Lekaj në emër të GP të AAK-së; Slavko Simiq, në emër të GP të LS; Fatmir Limaj, në emër të GP të “Nisma”, Sabri Hamiti, Muhamet Mustafa, zv.kryeministri Hajredin Kuçi, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Besim Beqaj, Sadri Ferati, Raif Qela, Glauk Konjufca, Rustem Berisha, Ismajl Kurteshi, Ramiz Kelmendi, Abdyl Ymeri, Shpejtim Bulliqi, Nenad Rashiq, Donika Kadaj-Bujupi, Shukri Buja, Enver Hoti, Faton Topalli, Sala Berisha-Shala, Shqipe Pantina, Albin Kurti, Teuta Haxhiu dhe Mytaher Haskuka, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin në parim të këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 82,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 12.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash:

V E N D O S I

1. Miratohet në parim Projektligjit nr. 05/L-120 për “Trepçën”.

2. Kuvendi i ngarkoi këto komisione:

- Komisionin Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit,
- Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

3. Komisionet e lartshënuara duhet që projektligjin ta shqyrtojnë në mbështetje të vendimit të Kuvendit nr. 05-V-358 dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 19:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale